



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZLAnr.137/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj - kryesues, Arsim Hamzaj, dhe Kymete Kicaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.10.2025, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZL. A.nr.137/2025 e datës 09.10.2025, e parashtruar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 09.10.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në të cilën pretendohet se aktivistët e LDK-së, kishin vërejtur se ishin vendosur materiale zgjedhore (fletushka/broshura zgjedhore), në korridorin para banesave në objektin kolektiv në rr. "Agim Ramadani" C1/9, në Prishtinë nga subjekti Lëvizja Vetëvendosje (LVV). Materialet janë shpërndarë pa pëlqimin dhe autorizim nga organi kompetent për shfrytëzimin e hapësirave të përbashkëta.

Lëvizja Vetëvendosje, ka shkelur neni 34 të Ligjit Nr. 08/L-228, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku shpërndarja dhe vendosja e materialeve

zgjedhore lejohet vetëm në hapësira të përcaktuara dhe të autorizuar nga organet kompetente.

Me tutje në ankesë theksohet sipas parimit të mbrojtjes së pronës private dhe të pronës së përbashkët në objekte kolektive, hapësirat e brendshme (korridoret, shkallët, hyrjet) nuk mund të shfrytëzohen për propagandë politike pa miratimin e banorëve ose organit menaxhues. Andaj, duke u mbështetur në ligjet dhe aktet nënligjore për zgjedhjet e përgjithshme, kërkojmë që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Provë: Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si prova fotografi në cilat shihen njoftimet e shpërndara.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik thekson se ankuesi nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse se fotografitë e bashkëngjitura si provë të vendosura në korridorin dhe para dyerve të banesave në objektin kolektiv C1/9, në rr. "Agim Ramadani", ishin vendosur materiale nga Lëvizja Vetvendosje pa pëlqim dhe pa autorizim. Këto prova nuk mund ta provojnë shkelje nga ana e LVV. Në prova kishte tre fotografi që janë bërë në të njëjtin vend, e me të cilat nuk mund të dëshmohet assesi që përkrahës, anëtarë, vullnetarë, apo aktivistë të Lëvizjes Vetvendosje e kanë kryer veprimin për të cilin është ushtruar ankesa.

Me tutje në ankesë theksohet se përgjatë kësaj fushate me mijëra vullnetarë të LVV janë trajnuar dhe vazhdimisht u është potencuar rëndësia e garës fer dhe veprimet të cilat ndalohen me ligje dhe akte nënligjore. Në asnjë moment deri tani nuk ishin lënë broshurat para dyerve të banesave. Aktivistët kishin bërë fushatë "derë me derë" me qëllim të bashkëbisedimit me banorët e qytetit, dhe ishin të vetëdijshëm se lënia e broshurave para dyerve jo vetëm që nuk ka për efekt mbledhjen e votave, por përkundrazi një gjë e tillë do ti rritonte banorët të cilëve broshurat u lihen para dyerve.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës, se Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, ka shpërndarë material zgjedhor/njoftime brenda ndërtesave publike apo godinave për tubimin politik janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 i cili përcakton "Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim, paragrafi 2.2 vendosa e njoftimeve, pllakateve dhe postëreve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, në shenjat e trafikut publik, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna, ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizata ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve", pasi që në fotografitë e bashkëngjitura në ankesë shihen vetëm disa njoftime të shpërndara para dyerve të banesave, ndërsa nuk dihet vendi, ku konsiderohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

Në bazë të provave të bashkangjitura shkresave të lëndës dhe pretendimet e palës ankuese paneli vlerësoi se pretendimi ankimor për shpërndarjen e njoftimeve brenda ndërtesave për tubim publik janë të paqëndrueshme dhe si të tilla Paneli i refuzoi për faktin se subjekti politik LDK nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi, nuk ka arritur që të vërtetoj vendin ku konsiderohet se ka ndodhur shkelja e supozuar dhe se këto veprime janë ndërmarr nga subjekti politik kundër të cilit është paraqitur ankesa, për të ardhur në përfundim se janë bërë shkelje të dispozitave të lartëcekura të Nenit 34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe sipas Rregullore NR.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, neni 5, paragrafi 1. nën paragrafi 1.3 ankesat që dorëzohen në PZAP për shqyrtim duhet të përmbajnë këto të dhëna: 1.3. Vendin Kohën, datën dhe orën kur ka ndodhur shkelja, ku në rastin konkret parashtruesi i ankesës nuk ka dhënë hollësi që të dihet se ku janë shpërndarë këto njoftime, në cilën orë ka ndodhur shkelja e pretenduar dhe nga provat e ofruara nuk mund të identifikohet objekti se ku ka ndodhur shpërndarja e materialeve zgjedhore andaj në prani të këtyre rrethanave ankesa është refuzuar si e pabazuar.

Kështu që paneli vlerësoi se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se shkelësit e supozuar kanë shpërndarë material zgjedhor në hapësira të palejuara konkretisht në ndërtesa, nuk është dëshmuar me prova nga pala ankuese.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.137/2025 më datë 10.10.2025



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.